



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Mbledhja nr. 105

Prishtinë, më 16.7.2024, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Hykmete Bajrami, Arta Bajralija, Yllëza Hoti, Visar Korencia, Halil Thaqi, Mirlinda Tishukaj-Sadiku, Albana Bytyqi, Rashit Qalaj dhe Hajdar Beqa.

Munguan: Bekim Arifi, dhe Adem Hoxha.

Stafi mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj.

Pjesëmarrësit e tjerë: Samir Bllacaku dhe Driton Ujkani, nga ASHNA, Emine Fazliu, Auriora Emini dhe Driada Thaqi, nga ZKA. Bekim Gashi, Artizana Krasniqi nga GP-LVV, Egzon Dahsyla- Kallxo.com, Ema Krasniqi KDI.

Mbledhjen e kryesoi: Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 28.5.2024, me 11.6.2024 dhe 25.6.2024;
3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit, për Pasqyrat Financiare Vjetore të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror për vitin 2023. Të ftuar: Përfaqësuesit e ASHNA-së;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 28.5.2024, me 11.6.2024 dhe 25.6.2024.

Procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 28.5.2024, me 11.6.2024 dhe 25.6..2024, u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror për vitin 2023.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: Të nderuar, sot kemi të caktuar shqyrtimin e Raportit të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror për vitin 2023. Për këtë raport kemi të ftuar dhe të pranishëm Drejtorin e ASHNA-së.

z. Samir Bllacaku: Ky raport është caktuar për shqyrtim për shkak të opinionit. ZKA ka dhënë Opinion të kualifikuar për PVF-të e ASHNA-së për vitin 2023. Problemi kryesor është se Thesari, në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbartimore, ka kryer pagesa në vlerë totale prej 817,603€, në një kategori ekonomike jo të përshtatshme të shpenzimeve. Një çështje tjetër që ka ndikuar në opinion është nënvlerësimi i regjistrit të pasurisë kapitale në vlerë prej 354,000€, si rezultat i mosregjistrimit në SIMFK të pasurisë jo kapitale “Furnizimi, instalimi dhe funksionimi i sistemit të menaxhimit të trafikut ajror.” Gjetjet, të cilat janë përmendur edhe te çështjet që kanë ndikuar në opinion, fillimisht po i përmend dy pagesa. Pagesa e parë, më e madhe, e cila është marrë nga investimet kapitale për shkak të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, ishte në vlerë prej 793,073€. Ajo është përdorur për kompensimin e pagave për stafin e kontrollorëve të trafikut ajror. Këtu kam një pyetje për Drejtorin: si ka ardhur deri te ky rast? Ndërsa pagesa tjetër, në vlerë prej 24,530€, është realizuar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve. A është kjo një keqplanifikim i ASHNA-së apo si ka ndodhur që një shumë kaq e madhe të shfrytëzohet përmes vendimeve gjyqësore? Pse kontrollorët e trafikut ajror është dashur t'i realizojnë pagat e tyre përmes gjykatave? Këtu kam edhe një pyetje për ZKA-në, sepse te tabelat e realizimit të buxhetit mendoj se ka disa gabime teknike, për shkak se thuhet që investimet kapitale janë realizuar në masën 83%, ndërsa në fakt nuk ka mundësi të jetë kështu, sepse 793 mijë janë marrë për ekzekutimin e pagave. Kjo i bie që 31.44% e buxhetit nga kategoria e investimeve kapitale ka shkuar drejt pagave. Në tabelat e buxhetit është treguar se buxheti final dhe fillestar janë të barabartë, gjë që nuk është e vërtetë. Sa i përket nënvlerësimit, siç e përmenda edhe më lart, kemi një program që nuk është regjistruar në SIMFK, duke shkaktuar nënvlerësimin e regjistrit në vlerë prej 354,000€. ZKA –ja ka dhënë rekomandim edhe për këtë çështje dhe ka treguar se një gabim i tillë nuk paraqet një problem të veçantë, sepse pasuria e ASHNA-së është më e madhe se atë. Një gjetje tjetër është mangësia në menaxhimin e sistemit e-pasuria. ZKA-ja ka gjetur se me faj të ASHNA-së nuk është aktivizuar plotësisht sistemi i e-pasurisë. Kemi pasur raste në disa organizata, ku për shkak të mosfunksionimit në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ku përfshihet edhe administrata publike, ka ndodhur që sistemi të mos aktivizohet, prandaj kërkoj sqarime pse ka ndodhur kjo. Një çështje tjetër që dua të përmend është mospërmbyllja e planit të NJAB-së. ZKA-ja ka thënë se projekti “Sistemi i Trajnimit dhe Zhvillimit”, i

planifikuar të auditohej në fillim të vitit, nuk ishte kryer, pasi Drejtori i ASHNA-së kishte kërkuar nga NJAB që ta ndryshonte planin auditues për këtë temë. Kemi një përgjigje të gjatë nga drejtori te komentet. Ndërkohë, si raportuese, e kam shqyrtuar Ligjin për kontrollin e brendshëm të financave publike dhe, sipas ligjit, NJAB ka të drejtë të auditojë projektin. ZKA gjithashtu ka folur për largimin e Drejtoreshës së Auditimit, ku thuhet se ka ndodhur për shkak të mungesës së komunikimit. Presim sqarime mbi këtë çështje. Ndërkohë, Drejtor, ajo që më ka bërë përshtypje te komentet tuaja është se keni thënë që raportet kolegjiale dhe personale të ish-Drejtoreshës së Auditimit me zyrtarët e ZKA-së nuk duhet të ndikojnë në punën profesionale të ZKA-së, dhe se kjo gjetje nuk qëndron, prandaj duhet të largohet nga draft raporti aktual. Nga informatat që kemi marrë, nuk e di nëse mund të arrijmë te një konkluzion i tillë. Shembull, kam edhe një pyetje për ZKA-në: pse nuk kemi asnjë mostër të prokurimit? Ndërsa, te paragrafi për pajtueshmëri thuhet që gjithçka është në rregull, ndërkohë që ka informata që disa projekte kapitale janë duke u hetuar nga prokuroria. Unë konsideroj që në raport është dashur të përmendet se mostrat e prokurimit nuk janë përfshirë për shkak të kësaj çështjeje, por nuk i bie që gjithçka është në rregull përderisa kemi projekte që po hetohen nga prokuroria e shtetit. Fjalën ia kaloj z. Bllacaku dhe më pas hapim diskutimet për pyetje.

Samir Bllacaku ASHNA: Kemi gjithsej 4 gjetje. Me tri prej tyre jemi pajtuar, me një jo. Sa i përket gjetjes së parë, ky është një rast që ka filluar në vitin 2011, ku është bërë një ankesë për mospagesën e vikendeve për kontrollorët e trafikut ajror. Kjo ka zgjatur për 13 vite dhe kemi 3 vendime gjyqësore. Vendimi final ka ardhur nga Gjykata Supreme, andaj na ka ardhur një vendim përmbarimor që brenda 2 ditësh të caktohet një kategori ku mund të bëhet kjo pagesë. Ne i kemi treguar Thesarit që nga kategoria e pagave dhe mëditjeve nuk kemi buxhet për t'i bërë këto pagesa dhe, pas 2 ditësh, Thesari e ka bërë tërheqjen e parave nga kategoria e kapitaleve. Kemi edhe vite të tjera që kemi paguar vendime përmbarimore.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: Drejtor, para kësaj detyre, a keni qenë kontrollor dhe a keni qenë pjesë e kësaj padie?

Z. Bllacaku: Po, jam kontrollor i trafikut ajror dhe, pse kam qenë pjesë, e kam sprapsur këtë proces deri në Gjykatën Supreme.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: Njësia e brendshme e auditimit ka gjetur që orët për të cilat është marrë ky vendim kanë qenë të kalkuluara me 180%. Këtu kam një koment për ZKA-në: pse nuk është marrë më në detaje kjo çështje? Sepse, nëse gjatë javës ka rastisur që e mërkura të jetë pushim, ajo, sipas ligjit, paguhet me 50% më shumë, por ajo që ka ndodhur është se, përveç pagesës së plotë, është paguar si festë 50%, si honorar 30% dhe si ditë ekstra 100%. Kjo është gjetje e Drejtoreshës së Auditimit, e cila është larguar nga puna.

Z. Bllacaku: Kjo që po përmendni është një çështje tjetër që e kemi trajtuar edhe me ish-drejtoreshën e Auditimit dhe me ZKA-në, për të cilën mendoj se ende nuk ka të drejtë, a jo, andaj gjykata e ka kthye që kemi të drejtë dhe i meritojmë.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: Kjo po i bije që edhe sprapsja nuk ka qenë e drejtë. Sepse po thoni se e keni sprapsu pse keni qenë në pozitë dhe në anën tjetër po thoni se e keni merituar.

Samir Billacaku, ASHNA: Unë e kam sprapsu, pikërisht që mos të ketë keqkuptime të tilla dhe me ardh në një tryezë të tillë dhe të thuhet që s'është sprapsu po është realizuar pse ju jeni në një pozitë të tillë. Çështja e nënvlerësimit të regjistrit të pasurive. Nuk është se nuk janë pasqyruar, por për shkak të një gabimi teknik te klikët, nuk është pasqyruar në raport, por në sistem ekziston si i regjistruar.

Driton Ujkani: Sistemi ITM është një projekt 5.5 milion euro, pra janë pagesa në vazhdimësi për një periudhë 3 vjeçare. Të gjitha pagesat kanë qenë të regjistruara, përveç pagesës së fundit, që ka qenë e regjistruar në SIMFK, mirëpo ka qenë investim në vijim, jo në përdorim. Andaj në rastin e printimit të pasqyrave financiare mbi 1 mijë euro, ka rezultuar që nuk ka dalë në PVF. Andaj jemi pajtuar sepse auditimi i ZKA-së ka qenë për PVF, andaj meqenëse nuk ka qenë edhe pse ka qenë lëshim teknik.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: Drejtor, ky projekt prej 5.5 milion eurove, a është projekti që po hetohet për momentin dhe a po vazhdon apo e keni ndërprerë?

Driton Ujkani: Po vazhdon, sepse nuk ka procedurë që i ndalon projektet për shkak të një padie ose një kallëzimi. Përndryshe, mund të mbeteshim pa asnjë projekt në realizim, sepse gjithkush mund të ngrejë padi për një interes të caktuar. Përderisa nuk kemi vendim të gjykatës, projekti vazhdon.

Samir Billacaku, ASHNA: Sa për ta elaboruar pak këtë projekt. Hapësira e lartë ajrore e Kosovës menaxhohet nga NATO-ja, konkretisht nga Eurokontrolli që është 800 kilometra në veri. Kosova, për të qenë e gatshme për të rimarrë kontrollin e hapësirës së lartë ajrore, ka bërë investimin në këtë sistem. Pra, ky sistem lidhet ngushtë me rimarrjen e sovranitetit të hapësirës ajrore. Po vazhdoj sa i përket pasurive kapitale dhe jokapitale. Krejt e dimë se sistemi e-pasuria për 2 vite ka qenë jashtë funksionit, andaj kemi kaluar në lista Excel. U kthye në sistem nga mesi i vitit të kaluar, për të cilën nuk jemi njoftuar. Por nga momenti që e kemi marrë si informacion, kemi filluar që këto lista t'i futim në sistem. Andaj, ky proces është në përfundim.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: Mund të vazhdoni me gjetjet edhe pse ZKA për këtë çështje thotë se ju nuk e keni aktivizuar dhe na i jepni sqarimet pastaj.

Samir Billacaku, ASHNA: Sa i përket gjetjes së 4, janë 8 faqe komente dhe për mua as që është e gjetur dhe nuk e pranojmë si të gjetur, sepse kjo është bërë kryekëput vetëm për të pasqyruar që Drejtoresha e Auditimit është larguar nga puna. Andaj, nuk është dashur as ZKA të bjerë në atë nivel dhe të plasojë informata të tilla, sepse ky është raport zyrtar. Sepse largimi i saj nuk është larguar për këtë çështje.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: A mund të na tregoni pse është larguar?

Samir Billacaku, ASHNA: Është larguar nga komisioni disiplinor dhe në atë vendim janë edhe arsyet.

Visar Korenica: Ju a jeni ekspert financiar, jeni i shkolluar për auditim, apo e keni kryer një tjetër drejtim? Sepse kur plasoni akuza ndaj ZKA-së, duhet ose të jeni në nivel të tyre, ose të keni së paku argumente të mbështetura në fakte për të refuzuar një gjetje të ZKA-së, sepse kur e gjykoni një rast duhet të keni kujdes dhe të bazoheni në fakte. Sepse ZKA është institucion i pavarur, andaj duhet të keni kujdes në atë që e thoni.

Samir Billacaku, ASHNA: Sa i përket shkollimit tim, unë jam kontrollor i trafikut ajror, jam ekonomist, kam magistraturë në biznes dhe menaxhment dhe kam doktoratë në aviacionin civil. Po ashtu kam një seri trajnimesh në aviacionin civil të kryera në Romë. Ne e kemi të drejtën të mos pajtohemi me gjetjet, andaj e kam thënë që nuk e konsiderojmë si gjetje, sepse nuk e di se ku është gjetja këtu, nuk është përmbushur plani i AB-së. Por nëse i shikoni komentet, plani është përmbushur 100%. Unë e kam nënshkruar planin e AB-së. ASHNA, përveç AB-së, ka edhe një njësi të veçantë që ka të bëjë me çështje operationale.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: Çka është kjo njësi?

Samir Billacaku, ASHNA: Është departamenti për cilësi, siguri dhe sigurim.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: Por ky departament nuk është auditim.

Samir Billacaku, ASHNA: I ka kompetencat e auditimit.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: Jo, drejtor, ne mund të mos jemi profesionistë, por nuk është njësoj. Sepse Ligji për kontrollin e brendshëm të financave publike e përcakton që çdo organizatë buxhetore, e cila ka buxhetin mbi 5 milion euro, duhet të ketë edhe një njësinë e brendshme të auditimit. Nuk e keni lejuar drejtoreshën e njësisë së AB-së që të kryejë auditimin e trajnimit dhe menaxhimit. Ju e përmendët që keni doktoratë në aviacion. A mund të na përgjigjeni, kur e keni marrë doktoratën, a e keni kryer në vitin 2023, ju lutem?

Samir Billacaku, ASHNA: Po, e kam kryer gjatë vitit 2022-2023.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: Sipas të dhënave që ne i kemi, drejtoresha e AB-së është larguar sepse nuk është lënë të auditojë këtë sistem, pikërisht të trajnimit, sepse zotëria që e kemi këtu përballë ka kryer doktoratën në kuadër të atij sistemi. Ai ka qenë gjithashtu 59 ditë jashtë shtetit në Santallen të Zvicrës për të marrë doktoratën. Për ditët sa ka qëndruar atje, ka marrë meditje dhe iu janë paguar shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzimet e qëndrimit. Janë 12 module që zotëria i ka kryer. Po ashtu ekzistojnë dokumente që atë doktoratë e ka aprovuar vetë zotëria. Këto dokumente ekzistojnë, sepse drejtoresha e larguar i ka përmendur këto fakte edhe në media. Andaj, ju nuk e keni lënë të auditohet ky sistem sepse është penguar nga auditorja e brendshme që ka gjetur këto çështje. Pikërisht në datën kur prokuroria speciale e merr rastin për hetim, për projektin prej 5.5 milion eurosh, drejtoreshës së AB-së i ngritet komisioni i dytë disiplinor, me arsyetimin se ka komunikuar me Njësinë Qendrore Harmonizuese, që është njësi që bën mbikëqyrjen e të gjitha njërive të auditimeve të brendshme në kuadër të institucioneve të Kosovës. Një NJQHAB i thotë drejtoreshës që, në bazë të ligjit për kontrollin e brendshëm, neni 19, paragrafi 3, ti ke të drejtë të auditosh të njëjtin sistem. Por a e dini deri në çfarë mase mund të shkojnë keqpërdorimet? Jo vetëm që e ka larguar drejtoreshën, por me ligjin që e keni miratuar

ju të nderuar deputetë në seancën e kaluar, është shuar komplet njësia e auditimit të brendshëm. Duke thënë që për auditim do të kontraktojmë kompani private dhe a e dini çfarë ndodh kur kontraktohet një kompani private?

Samir Bllacaku, ASHNA: Ju përshtat gjetjet siç keni dëshirë. Drejtor, tregoni, sa ka kushtuar doktorata? A e keni aprovuar vetë doktoratën dhe si është sipas jush kjo çështje? Sepse edhe lënda për largimin e drejtoreshës është në gjykatë. Stafi juaj që punon në financa dhe stafi i juaj në zyrën ligjore kanë këto informata, nënshkrimet tuaja dhe të gjitha këto informacione, nesër pasnesër do t'i shihni në media.

Samir Bllacaku, ASHNA: Më vjen keq, por informacionet janë tërësisht të gabuara. Studimet që kam kryer, nuk ka paguar ASHNA për mua, zero euro. Sa i përket qëndrimit tim për 59 ditë në Zvicër, kjo nuk është aspak e vërtetë, sepse kanë qenë module hibride dhe modulet i kam kaluar nga zyra në Prishtinë.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: Nëse kanë qenë hibride, a mund të na tregoni sa ditë keni qëndruar gjatë vitit 2023?

Samir Bllacaku, ASHNA: Në janar kam qenë 7 ditë dhe shpenzimet janë mbuluar komplet sepse ka qenë donacion, për nivelin e lartë.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: A keni marrë mëditje prej ASHNA-s për sa keni qëndruar atje? Jeni shkuar për shkollim, për të kryer doktoratën dhe keni marrë mëditje, janë të dhëna që dalin këto.

Samir Bllacaku, ASHNA: Nuk po e mohoj që kam marrë mëditje dhe nuk është doktoratë, është më shumë trajnim.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: Po ju e thatë vetë që keni kryer doktoratën, e tani po e mohoni dhe thoni se është trajnim. Pse është dashur të merrni mëditje? Pse nuk e keni lejuar drejtoreshën e auditimit të auditojë këtë proces dhe sa ditë keni qëndruar gjatë muajve të tjerë?

Samir Bllacaku, ASHNA: Pasi po e përmendni auditorin, ju e dini se në ASHNA, para 2 vitesh është ngritur një aktakuzë për 8.5 milion euro për 2 zyrtarë të ASHNA-s, ndërsa auditorja jonë nuk ka bërë as 2 rreshta gjetje për këtë çështje. Prej 12 moduleve, unë kam qenë vetëm në modulën e parë dhe modulën e fundit në Zvicër, të gjitha modulet tjera i kam kryer në Prishtinë.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: Po pse nuk e keni lejuar auditorin të auditojë? Këtu kam edhe një pyetje për ZKA-në.

Mirlinda Tishukaj Sadiku: E nderuar kryetare, nuk po e lejoni zotërinë të përgjigjet, po e bëni pyetjen dhe po interferoni dhe po krijoni interaktivitet gjithë kohës. Po e shfrytëzoni hapësirën si kryetare, po bëni pyetje dhe nuk po e lejoni të përgjigjet. Nuk e njoh zotërinë, por jepjani hapësirë të përgjigjet.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: Zotëria është drejtori i ASHNA-s, të cilin e ka caktuar Qeveria e Republikës së Kosovës. Kur është caktuar si drejtor, nuk i ka pasur 240 kredi, por i ka pasur 180, dhe nuk i ka pasur 5 vite përvojë menaxheriale. Tani ka marrë doktoratë. Por këto janë në pyetje të taksave të qytetarëve të Kosovës.

Samir Billacaku, ASHNA: Asnjëherë nuk i është cenuar pavarësia funksionale auditorës. Të gjitha kontratat janë audituar. Ne auditohemi edhe nga departamenti për cilësi, i cili është i certifikuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil. Në pjesën operacionale auditohemi nga 3 njësi.

Mirlinda Tishukaj Sadiku: A është kjo për shkak të specifikës, sepse ndoshta nuk e kemi shumë të qartë?

Samir Billacaku, ASHNA: Po, është pikërisht për shkak të specifikës. Sepse janë kontrollorë të trafikut ajror që i nënshtrohen rregulloreve evropiane, nuk punojmë me rregullore të brendshme.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: Drejtor, të lutem, ne e kemi prezent, ndihmësauditorën e auditorës së përgjithshme, znj. Fazliu, dhe besoj se jemi kompetentë që të na e sqarojë këtë çështje. Departamenti që e keni ju për cilësi flet për cilësinë e shërbimeve, nuk kontrollon për përdorimin e buxhetit. NJAB është aty për të parë si shpenzohet buxheti. Fjalën ia kaloj znj. Fazliu.

Emine Fazliu, ZKA: Pyetjet që i parashtruat ju, edhe ne si zyre i kemi. Këto kanë ardhur nga informatat jashtë. ZKA është institucion i pavarur dhe kryen punën e vet bazuar në ligjet e Kosovës dhe standardet ndërkombëtare të auditimit. Një prej pjesëve që është kontestuar edhe prej drejtorit të ASHNA-s është se a kemi ne të drejtë të auditojmë punën e NJAB. Andaj po e theksoj se ZKA e ka parë pikëkyçën e NJAB për ta parë funksionimin dhe pavarësinë. Si ZKA, për të evituar punën e dyfishtë, ne marrim disa mostra po ashtu edhe atë se çka ka thënë AB dhe i verifikojmë. Drejtori e ka kontestuar që nga titulli i çështjes. Ne gjatë auditimit e kemi parë që janë kryer 8 nga 10 auditimet e planifikuara, plan të cilin e ka nënshkruar drejtori i ASHNA-s, dhe kur kemi pyetur pse nuk janë kryer auditimet, ne nga NJAB kemi marrë përgjigjen se nuk është lejuar auditimi pikërisht nga drejtori i ASHNA-s. Edhe ne si ZKA kemi departamentin e kontrollit dhe cilësisë dhe departamentin e metodologjisë, por këto nuk e mbulojnë fushëveprimin e auditimit të brendshëm. Përkundër komenteve nga drejtori, ne si ZKA, në rastet kur nuk pajtohemi, komentet e institucionit i shpalosim në tërësi ashtu siç i ka dhënë organizata buxhetore.

Samir Billacaku, ASHNA: Më duhet të lidhëm me atë që tha auditorja, që raportet e auditimit të NJAB-së, i marrin mos të bëjnë auditime të dyfishta dhe marrin mostra për të vërtetuar nëse qëndrojnë ato gjetje. Kisha dëshirë të dija që nga viti 2019 e tutje, a keni një gjetje që e ka gjetur NJAB në ASHNA dhe në bazë të tyre ju e keni vërtetuar një gjetje të tillë? Sepse unë mendoj që nuk keni asnjë.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: Drejtor, pasi po i dini të gjitha këto detaje, të lutem, a na tregon pse u largua drejtoresha, çfarë shkruan në raportin e komisionit disiplinor. Edhe komisionin disiplinor e ka ngritur dikush.

Samir Bllacaku, ASHNA: Komisioni disiplinor është institucion brenda ASHNA-s dhe aty ka 5 a 6 pika, të cilat në detaje nuk mund t'i di.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: Ju vetëm nuk jeni pajtuar me gjetjet e saj, prandaj keni ngritur komisionin.

Halil Thaqi: Kryetare, është dashur të na tregoni që diskutimi është personal me këtë zotëri dhe të paktën unë nuk do të kisha marrë pjesë në këtë takim.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: I nderuar deputet, mundeni kur të doni me e ndalë takimin.

Samir Bllacaku, ASHNA: Komisioni i parë disiplinor ka qenë komunikimi me NJQHAB, dërgimi i raportit në përputhje me ligjin, i cili thotë se raporti nuk dërgohet pa miratim, edhe pse ka qenë kërkesë e ZKA të mos dërgohet raporti pa nënshkrim.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: A na tregoni pse me ligjin aktual e keni shuar njësinë e auditimit të brendshëm?

Samir Bllacaku, ASHNA: Ligji për ASHNA-n dhe ligji për Aviacionin Civil, ku fushëveprimi e përcakton qartë që çdo rregullore dhe direktivë e BE-së për aviacionin civil ka përparësi mbi ligjet e Kosovës, për shkak të specifikave.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: Pse po i përziëni çështjet e shpenzimit dhe menaxhimit të parasë publike me rregulloret e funksionimit të aviacionit civil?

Samir Bllacaku, ASHNA: Ne si ASHNA bëjmë dy kërkesa buxhetore. Jemi e vetmja organizatë me të hyra të dedikuara në buxhetin e Republikës së Kosovës, për shkak të specifikave. Asnjë organizatë ndërkombëtare në fushën e navigimit ajror nuk vepron kështu. Një kërkesë buxhetore e bëjmë për buxhetin e Republikës së Kosovës, sepse jemi agjenci në kuadër të buxhetit dhe një tjetër për Autoritetin e Aviacionit Civil, për shkak se është rregullator dhe të hyrat i kemi nga operatorët airlines.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: Cila është rregullorja e kujt do qoftë në botë që për funksionimin e institucioneve tona mbizotëron një ligj të votuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës?

Samir Bllacaku, ASHNA: Rregulloret e Komisionit Evropian që kanë të bëjnë me aviacionin civil.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: Absolutisht jo, cila rregullore? Sepse përderisa jeni organizatë buxhetore, e keni për obligim të keni njësinë e brendshme të auditimit.

Samir Bllacaku, ASHNA: Po e kemi njësinë deri në miratimin e ligjit, sepse me miratimin e ligjit nuk do të jemi organizatë buxhetore.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: A nuk do të merrni më grande nga buxheti?

Samir Bllacaku, ASHNA: Jo, nuk do të marrim sepse financohemi direkt prej tarifës së shërbimeve.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: A ka mundësi edhe një sqarim këtu nga auditorja?

Emine Fazliu, ZKA: ASHNA e ka buxhetin e shpenzuar për vitin 2023, 6 milion e gjysmë, ndërsa të hyrat i ka 6 milion. Nuk është e vetmja organizatë që krijon të hyra. Çdo e hyrë derdhet në buxhetin e shtetit dhe pastaj me vendime të veçanta e kanë të drejtën ta shfrytëzojnë. Andaj nuk mund të përjashtohet si organizatë buxhetore, por e ka të drejtën të shfrytëzojë buxhetin, sepse disa organizata krijojnë të hyra por nuk e kanë të drejtën të shfrytëzojnë.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: Në vitin 2023, ASHNA ka marrë 1.7 milion euro grant nga buxheti. Dogana ka inkasim më të madh të hyrave, por këto derdhen në buxhetin e shtetit. Andaj, të hyrat që ASHNA i krijon, nuk janë për shkak të aftësive të jashtëzakonshme të individëve, por për shkak të specifikës së punës. Në ligj nuk keni dispozita kalimtare, ku thuhet se NJAB do të jetë aty derisa të mbeteni organizatë buxhetore dhe të merrni grant nga buxheti i shtetit.

Rashit Qalaj: Ne po e diskutojmë një raport me opinion të kualifikuar, dhe për ne si deputet raporti me një opinion të tillë, pavarësisht cilit institucion i takon, është raport i keq. Ju na dhatë disa shpjegime lidhur me çështjen kryesore që ka të bëjë me shpenzimin e mjeteve, nga investimet kapitale për paga e meditje, që ka dalë nga një proces gjyqësor. Ajo që nuk më pëlqen është që për të shmangur konfliktin e interesit, e thatë që e keni shteruar këtë proces deri në nivelin e Gjykatës Supreme. Kjo është procedurë që kushdo do ta kishte ndjekur, dhe nuk mund të thuhet se është bërë vetëm për të shpëtuar. Ndërsa në studimin që keni bërë jashtë, ishte një lëshim nga ana juaj, sepse doktoratura nuk është trajnim, por shkollim personal. Problemi kryesor këtu është çështja e auditimit të brendshëm. Auditimi i brendshëm është një institucion brenda institucionit që ekziston, dhe nuk mund të zëvendësohet nga asnjë departament, pavarësisht specifikave. Po ashtu, duke u thirrur në disa parime evropiane, nuk mund të anashkalohen institucionet thelbësore dhe vitale për institucionet vendore siç është auditimi i brendshëm. Ku është dërguar ai raport për të cilin është larguar auditorja e brendshme?

Samir Bllacaku, ASHNA: Është dërguar në NJQHAB, që është në kundërshtim me ligjin. Por nuk është suspenduar vetëm për këtë arsye; është një prej pikave nga raporti i komisionit disiplinor. Plani i auditimit është ndryshuar dhe për këtë ka procesverbale nga takimi i Komitetit të Auditimit dhe për këtë është njoftuar edhe ZKA.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: Sipas legjislacionit, plani i auditimit nuk mund të ndryshohet pa pajtueshmërinë e drejtorit të organizatës dhe pajtueshmërisë me drejtorin e njësisë së auditimit të brendshëm. Ndërsa siç e theksoi z. Qalaj, lidhur me trajnimet. Ai studim ka kredi

që mund të shfrytëzohet për rekrutimin dhe avancimin. Sepse nëse ka kredi, nuk është trajnim, sepse është pjesë e niveleve të arsimit terciar.

Rashit Qalaj: Pikërisht këtë pyetje pata edhe unë, sepse nëse ka kredi është diçka krejt tjetër. Sa i përket largimit, ajo është një procedurë tjetër dhe nëse ka ndodhur ndonjë paditë, do të zgjidhet ndryshe. Por ajo që po diskutohet është pse nuk është lejuar auditimi i pjesës që ka të bëjë me trajnimet, kështu e thotë raporti, jo unë.

Samir Bllacaku, ASHNA: Është thënë në opinion se ka kushtuar 22 mijë dollarë, por ishte një trajnim komplet pa shpenzime, i cili ka qenë falas. Diploma ka 36 kredi.

Mirlinda Tishukaj Sadiku: Pse nuk e keni paditur për shpifje?

Samir Bllacaku, ASHNA: Po e kam paditur.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: Pra, diploma ka kredi, është nivel i edukimit, nuk është trajnim. Jeni shkolluar dhe keni marrë diploma nga organizata. Krejt është në rregull, vetëm duhet të hiqni nga puna ata që po i nxjerrin të palarat.

Samir Bllacaku, ASHNA: Më duhet të sqaroj se kreditë e kësaj diplome nuk nostrifikohen në Kosovë. Ju jeni keqinformuar, sepse thoni se jeni pa përvojë. Por unë për disa vite kam udhëhequr departamente të ndryshme dhe kam pasur përvojën më të nevojshme për këtë pozitë.

Rashit Qalaj: Unë personalisht, sa kam punuar në polici, kam qenë në shumë trajnimet, andaj nuk duhet akuzuar askush. Por çështja e kredive është diçka tjetër. Kam edhe dy pyetje. Ne kemi një sinjalizues që na njofton se keni hapur tender për sigurime shëndetësore për 160 punëtorë dhe 340 anëtarë të familjeve të tyre. Na e sqaroni këtë. E dyta, si është bashkëpunimi juaj me aeroportin ndërkombëtar të Prishtinës, duke pasur parasysh incidentin që ka ndodhur në qershor, ku një punëtor i juaj është autorizuar nga kontrolli dhe një aeroplan ka ardhur me 200 pasagjerë, dhe për të mos goditur punëtorin është detyruar të ngrihet përsëri. E di që është hetuar, por nëse mundeni të na tregoni.

Samir Bllacaku, ASHNA: Po, ka ndodhur një incident, por punëtori nuk ka qenë i yni, por i aeroportit dhe ka qenë duke rregulluar dritat. Aeroplani nuk ka qenë duke zbritur, por duke u ngritur, dhe kur ka kaluar veturën, ka qenë rreth 700-800 metra lartësi. Por në çdo incident e trajtojmë seriozisht, por nuk duhet përhapur panik sepse nuk ka ndodhur ndonjë gjë e rëndë. Sa i përket sigurimeve shëndetësore, me rregulloren e ASHNA-s, punëtorëve u lejohet sigurimi shëndetësor dhe po e vërtetoj që kemi hapur tender për punëtorët dhe për familjarët e tyre, për shkak të mirëqenies së familjarëve. Këto nuk janë të hyra nga buxheti, por të hyra të dedikuara nga aviokompanitë që e lejojnë një gjë të tillë.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: Për sigurimet shëndetësore duhet të jepen sqarime, sepse asnjë institucion nuk ka sigurime shëndetësore. Policia e Kosovës nuk ka sigurime për vete, e lëre më për familjarët.

Mirlinda Tishukaj Sadiku: Policia e Kosovës ka marrëveshje me QKUK-në.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: Pse nuk i trajton QKUK-ja ata?

Rashit Qalaj: Edhe të hyrat që hynë tek ju janë të hyra në institucion të Kosovës dhe nuk mund t'i përdorni sipas dëshirës. Por mua më intereson, pasi që ende asnjë institucion nuk ka sigurime shëndetësore dhe nuk kemi një ligj për sigurime shëndetësore, ku e keni bazën që keni shpallur tender për sigurime shëndetësore?

40 mini

Samir Bllacaku, ASHNA: Rregullorja për përcaktimin e skemës së përbashkët tarifore e përcakton se për cilat shërbime kemi të drejtë të gjenerojmë të hyra. Ne e kemi sigurimin që dy vjet, është viti i tretë dhe mundohemi të jemi në përputhje me ofruesit e shërbimit të navigimit ajror në rajon. Duke marrë parasysh që gjenerojmë të hyra, na lejohet të bëjmë sigurime shëndetësore për familjarët e punëtorëve.

Rashit Qalaj: I nderuar, e keni të gjeturën kryesore që për shkak të mungesës së parave keni marrë para nga kategoria e investimeve kapitale për të paguar detyrimet që kanë dalë nga vendimet gjyqësore. Ndërkohë, po bëni sigurime shëndetësore edhe për familjarët e punëtorëve, duke thënë se keni tepricë të buxhetit. Këto janë shumë pyetje logjike.

Samir Bllacaku, ASHNA: Për shkak të procedurave të kërkuara brenda ligjit të buxhetit, kemi pasur të pamundur të përdorim mjete nga të hyrat e dedikuara për investime kapitale, edhe pse kemi pasur mjete nga të hyrat e dedikuara.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: Kjo do të thotë se është keqplanifikim nga ana juaj. Ne kemi edhe Trustin që ka të hyrat e dedikuara dhe çdo vit e ndryshojmë ligjin për të reflektuar ndryshimet në të hyrat që ata i marrin. Ndërsa ju, për shkak të të hyrave, keni shpallur tender për sigurim shëndetësor të familjarëve të punëtorëve. A do të vazhdoni të bëni sigurime shëndetësore edhe për familjarët e gjërë të punëtorëve nëse keni rritje të të hyrave? Pra, do ta pajisni krejt Kosovën me sigurime?

Samir Bllacaku, ASHNA: Sigurimet shëndetësore janë të përcaktuara vetëm për familjarët e ngushtë. Të hyrat që ASHNA i merr nga operimet ajrore janë të përcaktuara me rregullore të komisionit evropian, dhe nuk po bëjmë asgjë më shumë se sa që bën rajoni.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: Drejtuesit e rajonit kanë sigurime shëndetësore, ne nuk kemi. Policia e Kosovës nuk ka sigurime shëndetësore as për vete, e lëre më për familjarët e tyre. Ju nuk keni të drejtë ligjore të ofroni sigurime shëndetësore për familjarët e punëtorëve, dhe po keqpërdorni buxhetin e organizatës ku punoni. Nëse ndërroni vendin e punës, nuk do të keni sigurim shëndetësor. Policia e Kosovës që patrullon në veri dhe ruan njerëzit në Ujman, nuk ka sigurime shëndetësore as për vete as për familjarët e tyre. Bëhuni pak më seriozë; nuk ka asnjë rregullore që parasheh sigurim shëndetësor për familjarët e punëtorëve.

Mirlinda Tishukaj Sadiku: Duhet të merrem edhe me ju, kryetare, sepse po e shkelni vazhdimisht rregulloren. Ju na keni quajtur hajna, kam dëshmi me incizim.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: Mirlinda, fol çka të duash, por për mua çdo deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës që e mbron hajninë është hajn, nëse do ta përsëris prapë.

Mirlinda Tishukaj Sadiku: Qofsh e falur që gëzon imunitet. Ti vetëm në gjykatë ishe përballë. Singërisht, kjo është dëshpëruese dhe ofenduese. Më vjen keq për këtë nivel debati. Askush nuk të jep të drejtë t'i quash njerëzit hajna. Nëse ke diçka për të thënë, shko atje ku duhet. Ty asnjëherë nuk të kam thënë hajneshë për 2 milionëshin. Është e papranueshme.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: Të lutem, flasim për raportin. Më vjen keq që duhet të ulem në një tavolinë me ty.

Mirlinda Tishukaj Sadiku: Nuk kam nevojë për keqardhjen tënde. Thuaj këto deklaratat jashtë, ku nuk ke imunitet. Thuaj hajneshë kur të dalësh jashtë dhe trego.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: Kur të duash, nuk kam fare problem.

Mirlinda Tishukaj Sadiku: Vërtetë, kryetare, turp duhet të kesh. Edhe njëherë të kërkoj falje që ra diskutimi në këtë nivel. Sot u diskutua shumë pak për raportin sepse zonja kishte shumë më shumë informacion jashtë raportit. Unë si femër nuk ndihem mirë nëse një zonjë është larguar nga puna. Nëse ka pasur të drejtë, besoj janë institucionet tjera që do të vërtetojnë të drejtën e saj. Ne e kemi të drejtën t'i besojmë ZKA-së, sepse nuk jemi ekspertë për të ditur specifikën e aviacionit civil. Por, aty është një paqartësi lidhur me planin e punës së asaj zonje që ka të bëjë me sistemet operative, sa janë funksionale. A ka pasur raste kontestuese më herët, siç ndodhi në këtë raport, duke marrë parasysh se edhe ju keni vite në këtë institucion dhe ajo zonjë e auditimit. E dyta, sa i ka dëmtuar investimet kapitale përmbaruesi që ka marrë afër 800 mijë euro? Sepse kanë qenë të planifikuara për investime dhe kanë lënë një boshllëk. Po ashtu, lidhur me mallrat, shërbimet dhe komunalin, ku rekomandimi thotë se nuk ka filluar zbatimi. Pse nuk është zbatuar? Një çështje tjetër që kam parë në raport është se 62% e buxhetit për mallra dhe shpenzime nuk është shpenzuar në masë të lartë. A ka ndodhur vonesë në procedurën e rekrutimit? A ka pasur përsëritje të konkursit, apo pse ka ndodhur kjo? Sa e kam lexuar raportin e NJQHAB-it, nuk e kanë specifikuar këtë çështje që u diskutua këtu, dhe mendoj se kjo njësi duhet ta përmend.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: Para se t'i jap fjalën drejtorit. Deputetë, mos e ngrini zërin. Kur të doni, në cilin shesh të doni, dilni dhe secilën deklaratë që kam bërë në seancë apo në komision, e them kudo. Unë qëndroj prapa deklaratave të mia. Nëse keni diçka për të thënë, thoni. Bashkë dalim, ftoni gazetarët dhe unë e them çdo gjë që kam thënë, e them përsëri me kompetencë dhe integritet të plotë. Mirëpo, mos e ktheni çështjen në personale. Nuk e ke lexuar asnjë rresht të raportit dhe vjen këtu e më ofendon mua.

Mirlinda Tishukaj Sadiku: Kryetare, më gjete për të thënë s'e kam lexuar raportin? Mos të lutem, sepse që nga mbledhja e parë kam mbi 3 fletore të mbushura me shënime. Më shumë se sa ti, dhe mund të të tregoj shpesh çka ke deklaruar. Prandaj, mos më ofendo. Ti kërkon njëfarë ndershmërie, por kujdes fjalët dhe mos u detyro pastaj të kërkosh falje, sepse ke kërkuar falje edhe për raste të tjera.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: Kurrë nuk të kërkoj falje për asgjë, kurrë.

Mirlinda Tishukaj Sadiku: Unë them me shumë kur e përdor fjalën, sepse nuk kam dëshirë të bëjë akuza të pabaza.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: Asnjëherë nuk të kam thënë, s'është e vërtetë.

Mirlinda Tishukaj Sadiku: E keni thënë dhe për këtë, mund ti lëshoj prapë incizimet.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: Lëshoj kur të duash. Vazhdojmë drejtor me përgjigjet. Nëse i keni kuptuar pyetjet.

Mirlinda Tishukaj Sadiku: Këtë duhet me ma thënë drejtori. Nuk të jep askush të drejtë me vlerësua këtë. Sinqerisht, është katastrofë qasja jote, nuk të bënë nder as ty, kush jeni ju me më vlerësua?

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: Mirlinda faktet i dhamë, keqpërdorimet.

Mirlinda Tishukaj Sadiku: Çfarë fakte? Nëse është dikush që doli nga raporti, ajo jeni ju. Pyetjet e mia ndërlidhen komplet me raport. Andaj s'kam nevojë ju me më dhënë vlerësime. Kam marrë vlerësime kombëtare e ndërkombëtare mjaftueshëm andaj mos u bëni merak.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: Asnjëherë Mirlinda, nuk je subjekt i imi.

Samir Bllacaku (ASHNA): Sa për ridestinimin, e dimë që vendimet përmbarimore janë me afat 2 ditor dhe nuk kemi mundësi me ridestinu prej një kategorie në një kategori tjetër. Sa i përket mallrave dhe shërbimeve është e vërtetë. Kemi problem në rekrutimin e kontrollorëve, sepse nuk kemi një koeficient të kontrollorëve fillestar dhe besoj shumë shpejt do ta rregullojmë këtë.

Hajdar Beqa: Ne sot po e diskutojmë një raport të kryer nga ZKA dhe të gjitha të gjeturat që u përmendën janë të bazuara në raport. Pavarësisht informacioneve që i kemi nga sinjalizuesit, të cilëve u'a mundëson edhe ligji. Misioni juaj është të rritni nivelin e shërbimeve, që të jeni konkurrent si agjenci. Sa e kam parë raportin, jemi pajtuar me shumicën e gjetjeve, vetëm me një shtëni nuk jam pajtuar. Por ajo që s'më pëlqen janë mënyrat e komenteve. Sa i përket deklarimit që komisioni e ka larguar nga puna, kjo nuk më duket në rregull, sepse komisionet i formon dikush dhe ka një shkresë paraprake se pse duhet me u bërë ai komision. Sepse nuk mundesh me qenë drejtor i agjencisë dhe mos me ditë sakt pse dikush po del nga puna. Po ashtu nuk më pëlqen shuarja e auditimit të brendshëm, me arsyetimin se ju krijoni të hyra, sepse kemi plot institucione që krijojnë të hyra, por jo, nuk i amneston nga njësia e auditimit. Këtë çështje do ta ngrit edhe në seancë, sepse nëse ne i deformatojmë ligjet kështu dhe në vend se me rrit kontrollin, ne e ulim kontrollin. Sepse auditimet e brendshme janë të domosdoshme. Po ashtu departamenti që e përmendët për kontroll dhe cilësi, mund të ketë kontroll të operativës por jo kontroll financiar, sepse kontrollet financiare bëhen nga auditimet e brendshme dhe të jashtme. Nuk po dua të hy më as te shkollimi i juaj as te hetimi i projektit 5.5 milion, sepse u tha mjaft. Por dua të pyes për zbatimin e rekomandimeve. Keni pas 5 rekomandime në vitin 2022, cili rekomandim është zbatuar pjesërisht dhe cili nuk është zbatuar fare dhe pse. Po ashtu, a keni bërë planin e

veprimet për rekomandimet e vitit 2023. Po ashtu kisha dashtë ta dija cilat janë sfidat kryesore të këtij agjencioni dhe çfarë mund të bëjë shteti për të rritur cilësinë e agjencisë, sepse ndoshta keni nevojë për ekspert të kësaj fushe.

Samir Bllacaku (ASHNA): Nuk ka filluar zbatimi, te mallrat dhe shërbimet, komunalit. Sepse kemi të bëjmë me keqklasifikime. Sepse përveç vendimeve përmbartimore për personel, kemi të bëjmë edhe me vendime përmbartimore për shpronësime. Andaj këtë gjetje do ta kemi edhe vitin e ardhshëm. Pjesërisht është rasti i e-pasurisë të cilin e kam shpjeguar edhe më herët.

Hajdar Beqa: A keni problem me kuadro, me burime njerëzore?

Samir Bllacaku (ASHNA): Po kemi problem me kuadro, kryesisht me kontrollorë. Kemi minus 9 kontrollorë të trafikut ajror, që i kanë lënë vendin dhe punojnë me paga shumë të mëdha në shtetet tjera. Kemi ende kërkesa për lirim nga detyra, sepse shkojnë dhe marrin 10 fishin e pagave në vendet tjera.

Hajdar Beqa: Po ikja e kuadrove është sfidë për të gjitha institucionet, për të cilat Qeveria është dashur të ndërmerr veprimet, duke pas parasysh edhe inflacionin. Si deputet, ne shpesh marrim sinjalizime edhe për rekrutimin e stafit. Shembuj kanë qenë nepotizmi dhe familjarizimi. Shembuj te ju është që drejtori e ka zgjatur trajnimin edhe një javë vetëm për të hyrë nipi i tij në punë. Andaj, punësimet duhet të jenë transparente dhe në harmoni me ligjet.

Samir Bllacaku (ASHNA): Krejt këto sinjalizime e kanë vetëm një emër. Janë nga personi për të cilin sot u foli. Informatat po merren si të mirëqena, por këto informata asnjëherë s'janë të mirëqena.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: A e keni nipin e punësuar në ASHNA?

Samir Bllacaku (ASHNA): Po.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: Atëherë sinjalizuesi paska pasur të drejtë.

Samir Bllacaku (ASHNA): Nipi im është punësuar në 2018 dhe unë kam filluar si Drejtor në vitin 2021. Si kam mundur ta punësoj atë?

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: Ke pas vazhdimisht pozita aty dhe ke mundur edhe me punësu. Po ashtu ka informata që edhe për një projekt që ju e keni iniciuar dhe i cili është në hetim. Projekti është ritenderuar 3 herë, për t'u përshtatur kërkesat, duke ndryshuar numrin e punëtorëve të kërkuar. E pikërisht në ditën që ka filluar projekti, ju auditorit i keni ngritur komisionin hetimor.

Samir Bllacaku (ASHNA): Të gjitha informacionet për këtë projekt i kemi dhënë prokurorit.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: Informata tjetër prej sinjalizuesit është që nipi i shoferit është bërë kontrollor. A qëndron kjo?

Samir Bllacaku (ASHNA): Kjo vërtet është e tepërt.

Halil Thaqi: Që nga fillimi i kësaj mbledhjeje e pasth që është tendencioze dhe ka dikush interes personal për të dëmtuar drejtorin. Është hera e parë që po e shoh. U tha nga kryesuesja e komisionit që nuk ke qenë serioz për pagesat e mediave. Pyetja ime është: A ke vendosur ti apo Gjykata për ato pagesa? Sa kredi i keni pasur ju kur e keni marrë pozitën e drejtorit, sepse u tha që s'ke pasur kredi të mjaftueshme. Sa përvojë menaxheriale thuaje edhe një herë.

Samir Bllacaku (ASHNA): Për rastin e mëditjeve, është vendim i gjykatës dhe është realizuar përmes përmbartjes. Për rastin e zgjedhjes sime, kam pasur magjistraturë dhe kam pasur kredi të mjaftueshme. Kam 2 vendime të gjykatës dhe vendimin e KPMSHC që e vërtetojnë përgatitjen dhe përvojën time.

Hajdar Beqa: Lëndët që i çoni në Gjykatën Supreme, a keni avokat a ekspert të brendshëm? Ju e dini që Gjykata Supreme nuk ka kompetencë me ndal ekzekutimin e lëndëve. Andaj, ju kisha rekomanduar që kur e bëni mbrojtjen, të mund të mbroheni në fazën e parë sepse pastaj fazat e tjera janë situata krejt tjetër.

Emine Fazliu: Si ZKA, e thash edhe në fillim, bashkëpunimin e kemi me zyrën e auditimit të brendshëm. I marrim raportet, i shikojmë dhe nëse ka diçka që ne e kemi në fushëveprim dhe konsiderojmë që duhet trajtuar, e trajtojmë më hollësisht vet dhe për atë e marrim pronësinë. Kemi raste nëpër ministri që, bazuar në gjetjet e AB-së, kemi trajtuar gjetje të cilat edhe ne i kemi vërtetuar, pas verifikimit dhe saktësisht të gjetjes, e marrim si gjetje të ZKA-së, sepse është vërtetuar nga ne.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: Auditore, për plotësim, roli i AB-së është për të dhënë sinjale dhe për të marrë masa preventive menaxhmenti, që të eliminohen mangësitë.

Visar Korenica: Lajmi jo i mirë është që ky raport ka dalë i kualifikuar dhe mendoj se kjo duhet të jetë brengë edhe e juaja. Kjo lidhet me pyetjen e zhvendosjes së pagesës nga investimet kapitale. Pyetja për ZKA-në është nëse ka pasur mundësi ASHNA me përmirësuar me kohë këtë të gjetur.

Emine Fazliu: Të hyrat e dedikuara janë të hyrat që i ka mbledhur ASHNA në vitin paraprak. Secila nga këto është e saktësuar se në cilën kategori mund të shpenzohen. Në bazë të ligjit të buxhetit, kategoria e pagave dhe medijave është e vetmja kategori që nuk mund të bëjë transfere nga kategoritë tjera, për të mbuluar pagat dhe medijtë. Vendimi i gjykatës ka qenë formë e prerë, andaj edhe është kategoria që ka pësuar ndryshim nga buxheti fillestar. Si ZKA rekomandojmë, në bazë të Ligjit për menaxhimin e financave publike, mund të bëhen ridestinime. Organizata buxhetore e ka të lejuar 5%, ministria e financave 10%, qeveria 15%, e për shumën më të mëdha duhet të kalojë në Kuvend. Në momentin që ASHNA e ka konsideruar që mund të ketë kësi lloj ndryshimesh, është dashur të paraprijë kësaj. Ne e kemi përfunduar edhe RVA-në dhe fatkeqësisht, në raport me vitin 2022, vlera e keqklasifikimeve në vitin 2023 është dyfishuar, në nivel të përgjithshëm të buxhetit të shtetit.

Visar Korenica: Këto janë të dhëna për ju në mënyrë që në të ardhmen të mos keni gjetje të tilla dhe raporti të jetë i pamodifikuar e jo i kualifikuar. Drejtor, ky kompensim përmes përmbarimit, në kuadër të shumës së përgjithshme është përfshirë edhe kamata. Sepse nëse është paguar edhe kamata, është bërë edhe dëm buxhetit të shtetit e taksapaguesve të Kosovës.

Samir Bllacaku (ASHNA): Që të jem i sigurtë, është një proces i udhëhequr nga sindikata dhe nuk e di si ka qenë, vetëm e di që ka qenë shuma e njëjtë për të gjithë dhe nuk e di a ka qenë edhe pjesë e kamatës aty a jo.

Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit: Si raportuese për këtë raport, propozoj që ky raport të adresohet për seancë plenare, por pasi nuk kemi kuorum për votim, këtë do ta diskutojmë në mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoi në orën 13:40.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit

Hykmete Bajrami,

Kryetare e Komisionit